REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KESHILLI I BASHKISE KORCE**

**VENDIM**

**Nr 34 date 18.04.2012**

***Per rishqyrtimin e vendimit te Keshillit Bashkiak nr 29 dale 26.03.2012 « Mbi strukturen dhe pagat e administrates se Bashkise Korce »***

Keshilli i Bashkise Korce pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe bazuar ne nenin 32 te ligjit 8652, date 31.07.2000 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" dhe ligjin 8927 date 25.07.2002 " Per Prefeltin". ligjin 8549 date 11.11.1999 "Statusi I nepunesit civil", ligjin 7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes i Republikes te Shqiperise" Ligjin nr.10487 date 05.12.2011 "Per buxhetin e vitit 2012", Udhezimin Nr.2 date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te Buxhetit", Udhezimi nr 2/1 date 15.02.2012 "Per zbatimin e buxhetit 2012", Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", ligjin 10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin". V.K.M Nr.1619 datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive te qeverisjes vendore. për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave re punonjësve të organeve te qeverisjes vendore", i ndryshuarsi dhe mbas diskutimeve te Keshilltareve

## VENDOSI

1. Te lere ne fuqi VKB nr 29 date 26.03.2012 « Mbi strukturen dhe pagat e administrates se Bashkise Korcs » me ndryshimet si me poshte :
    - Drejtore e Drejtorise se Finances do te paguhet sipas kategorise IIb me shtese page per pozicion 48 000 (dyzet e tete mije lek) dhe jo sipas kategorise Ib
    - Ne pozicioninin e pergjegjesit te mbledhjes se te ardhurave dhe pergjegjeses per implementimin e projekteve social kulturore, pas fjales pergjegjes shtohet fjala *sektor*.
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances dhe Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerezore Protokoll Arkives dhe Sherbimeve Mbeshtetese
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite nga data e shpalljes

**KRYETARI**

**Ilir PENDAVINJI**

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP www.infocip.org